



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 15 paragrafi 15.4, neni 33 paragrafi 33.3 dhe neni 34 Ligji Nr.02/L-8 për Verëra, 14 tetor 2005,
Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 15/2009
Për Caktimin e parametrave të analizave fiziko-kimike të verës**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kufijtë e epërm dhe të poshtëm për parametrat nga analizat fiziko-kimike për të gjitha llojet e verës sipas kategorizimit të vjeljes konfrom standardeve të Bashkësisë Evropiane.

**Neni 2
Përmbajtja e alkoolit**

1. Përmbajtja më e vogël e alkoolit natyror në verë e cila vendoset në qarkullim, në varësi nga zona dhe kualiteti i prodhimit, duhet të jetë në volum % si vijon:

- 1.1 Vera e tryezës dhe vera e tryezës me prejardhje të caktuar gjeografike 10,0 vol %;
- 1.2 Vera cilësore me prejardhje të caktuar gjeografike 10,5vol %
- 1.3 Vera kulminante me prejardhje të caktuar gjeografike 11,5vol %.

**Neni 3
Përmbajtja e dioksidit të sulfurit**

1. Përmbajtja e përgjithshme e dioksidit të sulfurit në verë, përveç verërave shkumbore, të gazizuara dhe verërave speciale që vendosen në treg nuk duhet të jetë më e madhe se:

- 1.1 160 mg/l te verërat e kuqe, prej tij të lirë më së shumti 30 mg/l SO₂
- 1.2 210 mg/l te verërat e bardha dhe roze, prej tij të lirë më së shumti 40 mg/l SO₂.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 e këtij neni, përmbajtja e përgjithshme e dioksidit të sulfurit të verërat me mbetje të sheqerit më shumë se 5 g/l i shprehur si sheqer reduktues, mund të jetë:

- 2.1 210 mg/l te verërat e kuqe , prej tij të lirë më së shumti 40 mg/l SO₂;
- 2.2 260 mg/l te verërat e bardha dhe roze, prej tij të lirë më së shumti 50 mg/l SO₂;
- 2.3 300 mg/l, prej tij të lirë më së shumti 50 mg/l SO₂ te verërat me shenjën vjelje e vonë;

- 2.4 350 mg/l, prej tij të lirë më së shumti 60 mg/l SO₂ te verërat me shenjën vjelje e zgjedhur;
- 2.5 400 mg/l, prej tij të lirë më së shumti 70 mg/l SO₂ te verërat me shenjën vjelje e zgjedhur e kokrrave të rrushit, vjelje e zgjedhur e kokrrave të thara të rrushit dhe vera e ngrirë.

Neni 4

Përmbajtja e acideve avulluese

1. Acidet avulluese, të shprehura si acid acetik, në prodhimet që vendosen në qarkullim nuk duhet të jetë më shumë se:
 - 1.1 0,8 g/l në mushtin gjatë fermentimit dhe në verë të re;
 - 1.2 1,0 g/l te vera e bardhë dhe roze;
 - 1.3 1,2 g/l në verërat e kuqe, në verërat e vjeljes së vonë, dhe verërat me shenjën vjelje e zgjedhur;
 - 1.4 1,8 g/l tek verërat deserte, verërat me vjelje të zgjedhur të kokrrave të rrushit, verërave me vjelje të zgjedhur të kokrrave të thara dhe verës së ngrirë.
2. Kufijtë e acideve avulluese nga paragrafi 1 i këtij neni vlejné për të gjitha prodhimet nga rrushi të prodhuar në Republikën e Kosovës.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, acidet avulluese mund të jenë më të mëdha te verërat me shkallë të fortësisë alkoolike me shumë se 13 vol%.

Neni 5

Përmbajtja ekstraktit të thatë pa sheqer

1. Vera e tryezës dhe vera e tryezës me prejardhje gjeografike të cilat vendosen në qarkullim, duhet të përmbajnë sasinë minimale të ekstraktit të thatë pa sheqer si:
 - 1.1 Vera e bardhë 15 g/l;
 - 1.2 Vera roze 16g/l;
 - 1.3 Vera e kuqe 17g/l.

Neni 6

Vera cilësore

1. Vera cilësore e cila vendoset në qarkullim, duhet të përmbajë sasinë minimale të ekstraktit të thatë pa sheqer:
 - 1.1 Vera e bardhë 17g/l;
 - 1.2 Vera roze 18g/l;
 - 1.3 Vera e kuqe 19g/l.

Neni 7

Vera kulminante

1. Vera Kulminante e cila vendoset në qarkullim, duhet të përmbajë sasinë minimale të ekstraktit të thatë pa sheqer:
 - 1.1 Vera e bardhë 18g/l;
 - 1.2 Vera roze 19g/l;
 - 1.3 Vera e kuqe 20 g/l.

Neni 8

Verërat shkumbore dhe të gaziruara

1. Te verërat shkumbore dhe të gaziruara, përmbajtja e dioksidit të sulfurit lejohe të jetë deri 250 mg/l, prej të cilit dioksidi i sulfurit të lirë duhet të jetë deri 20mg/l.

2. Verërat natyrore shkumbore dhe të gaziruara sipas përmbajtjes së sheqerit të reduktuar ndahen në:

- 2.1 ekstra brut, më pak se 6 g/l;
- 2.2 brut, më pak se 15 g/l;
- 2.3 shumë e thatë - ekstra sek , dry ndërmjet 12 – 20 g/l;
- 2.4 e thatë - dry, ndërmjet 17-35g/l;
- 2.5 gjysmë e thatë -demi sec, ndërmjet 33 – 50 g/l;
- 2.6 e ëmbël - doux, më shumë se 50 g/l.

Neni 9

Verërat Deserte

1. Verërat Deserte dhe Verërat Cilësore Deserte, duhet të përmbajnë minimum 15% fortësi deri në maksimum 22% fortësi alkoolike natyrore.

2. Përmbajtja e tërësishme e dioksidit të sulfurit tek verërat deserte, duhet të jetë:

- 2.1 210 mg/l, prej tij 40 mg/l sulfur të lirë, tek verërat me më pak se 50g/l të sheqerit reduktues;
- 2.2 300 mg/l, prej tij 50 mg/l sulfur të lirë, tek verërat me më shumë se 50g/l të sheqerit reduktues.

Neni 10

Verërat Likere

1. Verërat Likere të cilat vendosen në qarkullim, duhet të kenë minimum 15% deri maksimum 22% vol alkool natyror. Alkooli i tërësishëm më së paku, duhet të jetë 17,5 % vol, dhe më së shumti 27,5 % vol.

2. Përmbajtja e tërësishme e dioksidit të sulfurit tek verërat likere, duhet të jetë:

- 2.1 150 mg/l, prej tij 30 mg/l sulfur të lirë, tek verërat me më pak se 5g/l të sheqerit reduktues;
- 2.2 200 mg/l, prej tij 40 mg/l sulfur të lirë, tek verërat me më shumë se 5g/l të sheqerit reduktues.

Neni 11

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 48 Ligji Nr.02/L-8 për verëra.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 18.12.2009

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
